

Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Profesioneve të Avokatëve

Luksemburg, 13.V.2025

Preambulë

Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe nënshkruesit e tjerë të kësaj Konvente,

Duke pasur parasysh se qëllimi i Këshillit të Evropës është të arrijë një unitet më të madh midis anëtarëve të tij;

Duke kujtuar Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (ETS Nr. 5, 1950) dhe Protokollet e saj, si dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;

Duke marrë parasysh Parimet Themelore mbi Rolin e Avokatëve, të miratuara nga Kongresi i Tetë i Kombeve të Bashkuara mbi Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e Shkelësve të Ligjit (Havana, Kubë, 27 gusht - 7 shtator 1990);

Duke marrë parasysh Rekomandimin Rec (2000) 21 të Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve anëtare mbi lirinë e ushtrimit të profesioneve të avokatëve;

Duke marrë parasysh Rezolutën 44/9 mbi pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit, anëtarëve të trupave gjykues dhe vlerësuesve, si dhe pavarësinë e avokatëve, të miratuar nga Këshilli i të Drejtave të Njeriut i Kombeve të Bashkuara më 16 korrik 2020;

Duke theksuar rolin themelor që luajnë avokatët dhe shoqatat e tyre profesionale në mbështetjen e sundimit të ligjit, sigurimin e aksesit në drejtësi dhe garantimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe lirive themelore;

Duke vërejtur me shqetësim të thellë se avokatët po i nënshtrohen gjithnjë e më shumë sulmeve, kërcënimeve, ngacmimit dhe frikësimit për shkak të veprimtarive të tyre profesionale, si dhe pengesës ose ndërhyrjes së papërshtatshme gjatë kryerjes së veprimtarive të tyre legjitime profesionale;

Duke dënuar të gjitha sulmet, kërcënimet, ngacmimin, frikësimin dhe pengesën ose ndërhyrje të papërshtatshme të tillë;

Duke marrë parasysh mënyrën e ndryshme në të cilën profesioni i avokatit mund të organizohet në Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe nënshkruesit e tjerë të kësaj Konvente;

Duke marrë parasysh nevojën për të forcuar kuadrin ligjor ndërkombëtar për të garantuar lirinë e ushtrimit të profesioneve të avokatëve,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Kapitulli I – Qëllimi, fushëveprimi dhe përdorimi i termave

Neni 1 – Qëllimi i Konventës

1. Qëllimi i kësaj Konvente është të forcojë mbrojtjen e profesionit të avokatit dhe të drejtën për ta ushtruar këtë profesion me pavarësi dhe pa diskriminim, pengesë ose ndërhyrje të papërshtatshme, ose pa iu nënshtruar sulmeve, kërcënimeve, ngacmimit ose frikësimit.
2. Kjo Konventë përcakton një mekanizëm specifik për të garantuar një zbatim efektiv të dispozitave të saj nga Palët.

Neni 2 – Fushëveprimi

1. Kjo Konventë zbatohet për veprimtaritë profesionale të avokatëve dhe të shoqatave të tyre profesionale.
2. Dispozitat në Nenet 5 deri 9 të kësaj Konvente, në masën që lidhen me situatën e tyre specifike, janë të zbatueshme për ata avokatë që ofrojnë, sipas titullit të tyre të origjinës, konsulencë, ndihmë ose përfaqësim ligjor në një Palë dhe të cilët:
 - a. përfshihen brenda fushëveprimit të një deklarate të bërë nga një Palë tjetër sipas Nenit 20, paragrafi 1 të kësaj Konvente; ose
 - b. duke e bërë këtë në përputhje me ligjin e asaj Pale, të drejtën e Bashkimit Evropian ose marrëveshjet ndërkombëtare.
3. Dispozitat në Nenet 6 (të drejtat profesionale të avokatëve), 7 (liria e shprehjes) dhe 9 (masat mbrojtëse), paragrafi 4 të kësaj Konvente zbatohen gjithashtu për:
 - a. çdo person të cilit, në shkelje të Neneve 5 dhe 8 të kësaj Konvente, i është refuzuar kualifikimi i avokatit ose një licencë për të ushtruar profesionin ose i janë revokuar ose pezulluar;
 - b. çdo person që njihet nga një gjykatë ose tribunal ndërkombëtar, ose një organ i krijuar nga një organizatë ndërkombëtare, si kompetent për të vepruar në procedurat para tij kur këshillon ose vepron në procedura të tilla.
4. Dispozitat në Nenet 6, paragrafi 3, nënparagrafët b dhe c, dhe 9, paragrafi 4 të kësaj Konvente zbatohen edhe për personat e punësuar ose të angazhuar nga avokatët për t'i ndihmuar ata, në masën që kontribuojnë drejtpërdrejt në kryerjen e veprimtarive profesionale të këtyre avokatëve.

5. Dispozitat në Nenin 9, paragrafi 4 të kësaj Konvente, zbatohen edhe për personat e punësuar ose të angazhuar për të ndihmuar shoqatat profesionale, në masën që lidhen me kryerjen prej tyre të veprimtarive profesionale të këtyre shoqatave.

Neni 3 – Përdorimi i termave

Për qëllimet e kësaj Konvente:

- a. “avokat” do të thotë çdo person fizik i cili është i kualifikuar dhe i autorizuar, sipas ligjit kombëtar, për të ushtruar profesionin e avokatit;
- b. “klient” do të thotë çdo person fizik ose juridik që këshillohet, ndihmohet ose përfaqësohet nga një avokat;
- c. “klient i mundshëm” do të thotë çdo person fizik ose juridik që kërkon, qoftë drejtpërdrejt ose tërthorazi, të këshillohet, të ndihmohet ose të përfaqësohet nga avokati përkatës;
- d. “shoqatë profesionale” do të thotë një organ përfaqësues në të cilin bëjnë pjesë disa ose të gjithë avokatët, qoftë drejtpërdrejt ose tërthorazi, ose janë të regjistruar dhe që ka përgjegjësi të caktuar për organizimin ose rregullimin e profesionit të tyre sipas ligjit kombëtar;
- e. “veprimtari profesionale të avokatëve” do të thotë çdo veprim për përgatitjen ose ofrimin e konsulencës, ndihmës ose përfaqësimit për një klient ose klient të mundshëm në lidhje me interpretimin ose zbatimin e ligjit, qoftë kombëtar, i huaj apo ndërkombëtar, si në Palët ku janë vendosur, ashtu edhe kudo tjetër ku mund të ndërmerret, duke përfshirë në lidhje me procedurat dhe punën e një gjykate ose tribunali ndërkombëtar ose të një organi të krijuar nga një organizatë ndërkombëtare;
- f. “veprimtari profesionale të shoqatave profesionale” do të thotë çdo veprim i mbuluar nga Neni 4, paragrafi 2 i kësaj Konvente;
- g. “autoritete publike” do të thotë:
 - i. qeveria dhe administrata në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor;
 - ii. organet legjislativë dhe autoritetet gjyqësore në masën që kryejnë funksione administrative sipas ligjit kombëtar;
 - iii. persona fizikë ose juridikë në masën që ushtrojnë autoritet administrativ;

h. “e përcaktuar me ligj” dhe “e nevojshme në një shoqëri demokratike” do të kuptohen brenda përkufizimit të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, siç interpretohet nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Kapitulli II – Dispozitat materiale-

Neni 4 – Shoqatat profesionale

1. Palët sigurojnë që kuadri ligjor dhe rregullator kombëtar të garantojë që shoqatat profesionale të jenë organe të pavarura, vetëqeverisëse. Çdo zgjedhje e organeve të tyre ekzekutive duhet të bëhet në përputhje me rregullat në fuqi dhe pa ndërhyrje të jashtme.

2. Palët do të sigurojnë që shoqatat profesionale mund të:

a. promovojnë dhe përfaqësojnë interesat e avokatëve dhe të profesionit të tyre;

b. promovojnë dhe mbrojnë pavarësinë e avokatëve dhe rolin e tyre në shoqëri;

c. hartojnë standardet profesionale të sjelljes dhe nxisin respektimin e tyre, në përputhje me këtë Konventë;

d. nxisin aksesin në profesion dhe arsimimin dhe trajnimin e vazhdueshëm të avokatëve;

e. bashkëpunojnë me avokatët, shoqatat e tjera profesionale dhe organizatat ndërkombëtare, ndërqeveritare ose joqeveritare për çështje të ligjit dhe praktikës së ligjit, duke përfshirë nxitjen dhe mbrojtjen e rolit të avokatëve; dhe

f. promovojnë mirëqenien e avokatëve dhe t'i ndihmojnë ata dhe familjet e tyre, kur është e nevojshme.

3. Palët do të sigurojnë që shoqatat profesionale të konsultohen në një mënyrë të shpejtë dhe efektive mbi propozimet e qeverisë për çdo ndryshim në legjislacion, rregulla procedurale dhe administrative që ndikojnë drejtpërdrejt në veprimtaritë profesionale të avokatëve dhe rregullimin e profesionit.

4. Palët do të sigurojnë që çdo kërkesë për t'u bërë pjesë e një shoqate profesionale, të mos i pengojë avokatët që të formojnë dhe të marrin pjesë në shoqata të tjera për të promovuar interesat dhe veprimtaritë e tyre profesionale.

Neni 5 – E drejta për të ushtruar profesionin

1. Palët sigurojnë që pranimi, autorizimi i vazhdueshëm dhe ripranimi për të ushtruar profesionin si avokat, të përcaktohen me ligj dhe të:

a. bazohen në kritere objektive, relevante dhe transparente që zbatohen nëpërmjet një procesi të drejtë; dhe

b. mos i nënshtrohen diskriminimit për ndonjë arsye të ndaluar nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

2. Palët sigurojnë që vendimet në lidhje me pranimin, autorizimin e vazhdueshëm dhe ripranimin për të ushtruar profesionin e avokatit, të merren nga një shoqatë profesionale ose organ tjetër i pavarur dhe t'i nënshtrohen oponencës para një gjykate ose tribunali të pavarur dhe të paanshëm të krijuar me ligj.

Neni 6 – Të drejtat profesionale të avokatëve

1. Palët do të sigurojnë që avokatët të mund të:

a. ofrojnë dhe japin konsulencë, ndihmë dhe përfaqësim ligjor, duke përfshirë për qëllimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe lirive themelore;

b. pranojnë ose refuzojnë të pranojnë ndonjë person fizik ose juridik si klientë të tyre dhe të ndërpresin marrëdhënien avokat-klient;

c. kenë akses të shpejtë dhe efektiv tek klientët e tyre dhe klientët e mundshëm, edhe kur ata janë të privuar nga liria;

d. njihen si persona të autorizuar për të këshilluar, ndihmuar ose përfaqësuar klientët e tyre;

e. kenë akses efektiv në çdo material përkatës në zotërim ose kontroll të autoriteteve publike, gjykatave dhe tribunaleve kompetente kur veprojnë në emër të klientëve të tyre, pa vonesë dhe kufizime të panevojshme;

f. kenë akses dhe komunikim efektiv me një gjykatë, tribunal ose organ tjetër të ngjashëm para të cilit janë të kualifikuar të paraqiten;

g. paraqesin kërkesa ose aplikime në emër të klientëve të tyre, duke përfshirë në lidhje me përjashtimin e një gjyqtari, prokurori ose anëtari të një organi të thirrur për të vendosur në një çështje të caktuar dhe për zhvillimin e procedurave;

h. marrin pjesë në mënyrë efektive në të gjitha procedurat në të cilat veprojnë në emër të klientëve të tyre;

i. informojnë publikun rreth shërbimeve të tyre.

2. Palët do të sigurojnë që avokatët nuk do të kenë përgjegjësi civile ose penale për deklaratat me gojë dhe me shkrim, të bëra me mirëbesim dhe përkushtim- gjatë kryerjes së të gjitha procedurave në emër të klientëve të tyre.

3. Palët sigurojnë që avokatët:

a. të mund t'u ofrojnë klientëve të tyre ose klientëve të mundshëm konsulencë ligjore privatisht kur takohen me ta personalisht;

b. të mund të komunikojnë në mënyrë konfidenciale me klientët e tyre ose klientët e mundshëm, me çfarëdo mjeti dhe në çfarëdo forme që mund të ndodhë një komunikim i tillë;

c. të mos jenë të detyruar të zbulojnë, dorëzojnë ose japin prova në lidhje me ndonjë informacion ose material të marrë, qoftë drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga klientë ose klientë të mundshëm, si dhe çdo shkëmbim me ta dhe çdo material të përgatitur në lidhje me këto shkëmbime ose me kryerjen e procedurave ligjore në emër të tyre.

4. Nuk do të vendosen kufizime në ushtrimin e të drejtave të përcaktuara sipas paragrafëve 1, 2 dhe 3 të këtij Neni, përveç atyre të përcaktuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike. Kufizime të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në kërkesa që synojnë të garantojnë disponueshmërinë e konsulencës, ndihmës dhe përfaqësimit ligjor për të gjithë.

5. Palët sigurojnë që avokatët të mos vuajnë pasoja negative si rezultat i identifikimit me klientët e tyre ose me çështjen e klientëve të tyre. Ky Nen zbatohet pa cenuar lirinë e shprehjes, siç mbrohet nga Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe legjislacioni i brendshëm.

Neni 7 – Liria e shprehjes

1. Palët sigurojnë të drejtën e avokatëve për të informuar publikun rreth çështjeve të klientëve të tyre, duke iu nënshtruar vetëm kufizimeve të përcaktuara me ligj dhe që rrjedhin nga përgjegjësitë profesionale, kërkesat e administrimit të drejtësisë dhe respektimi i jetës private, dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike.

2. Palët sigurojnë të drejtën e avokatëve, individualisht dhe bashkërisht, dhe të shoqatave profesionale për të nxitur sundimin e ligjit dhe respektimin e tij, për të marrë pjesë në diskutim

publik mbi përmbajtjen, interpretimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore ekzistuese dhe të propozuara, vendimeve gjyqësore, administrimin dhe aksesin në drejtësi dhe promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe për të bërë propozime për reforma në lidhje me këto çështje.

Neni 8 – Disiplina

1. Palët sigurojnë që arsyet për masë disiplinore kundër avokatëve të bazohen ekskluzivisht në standardet profesionale të sjelljes të cilat përcaktohen me ligj dhe që janë vetë në përputhje me të drejtat dhe liritë në Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

2. Palët do të sigurojnë që procedurat disiplinore kundër avokatëve:

a të ngrihen para:

i. një komisioni disiplinor të pavarur dhe të paanshëm, të krijuar nga një shoqatë profesionale,

ii. një autoriteti të pavarur dhe të paanshëm, ose

iii. një gjykate ose tribunali të pavarur dhe të paanshëm të krijuar me ligj;

b. të trajtohen me shpejtësi;

c. të zhvillohen në përputhje me kërkesat për një gjykim të drejtë sipas Nenit 6 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe me të drejtën për t'u këshilluar, ndihmuar ose përfaqësuar nga një avokat sipas zgjedhjes së tyre; dhe

d. t'i nënshtrohen një oponence nga avokati përkatës para një gjykate ose tribunali të pavarur dhe të paanshëm, të krijuar me ligj.

3. Palët sigurojnë që çdo sanksion disiplinor i vendosur ndaj avokatëve, të respektojë parimet e ligjshmërisë, mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit. Çdo ndalim i së drejtës për të ushtruar profesionin, duhet të vendoset vetëm për shkeljet më të rënda të standardeve profesionale.

Neni 9 – Masat mbrojtëse

1. Palët sigurojnë, në bazë të kufizimeve të përcaktuara me ligj dhe të nevojshme në një shoqëri demokratike për parandalimin, hetimin ose ndjekjen penale të një krimi ose për mbrojtjen e të drejtave të tjerëve, që avokatët:

a. të kenë akses në një avokat sipas zgjedhjes së tyre, në rast të privimit nga liria e tyre;

b. të mund të informojnë një përfaqësues të shoqatës së tyre profesionale, pa vonesë të panevojshme, në lidhje me privimin e tyre nga liria, bazën ligjore për të dhe vendin ku mbahen;

c. të kenë të pranishëm një avokat të pavarur ose një përfaqësues të shoqatës së tyre profesionale gjatë:

i. ndonjë kontrolli të kryer si pjesë e një hetimi ose procesi civil, penal ose administrativ, qoftë të tyre ose të ndonjë ambienti, automjeti ose pajisjeje të përdorur prej tyre për veprimtaritë e tyre profesionale; ose

ii. sekuestrimit ose fotokopjimit të dokumenteve, ndonjë të dhëne tjetër dhe ndonjë lloj pajisjeje të përdorur prej tyre për veprimtaritë e tyre profesionale;

përveç rasteve kur nuk do të ketë shqyrtim të dokumenteve ose të dhënave nga ata që kryejnë kontrollin ose sekuestrimin;

d. të informohen për të drejtat e tyre në nënparagrafët a, b dhe c të këtij paragrafi, kur privohen nga liria dhe përpara se t'i nënshtrohen kontrolleve ose sekuestrimit ose fotokopjimit të dokumenteve.

2. Palët do të sigurojnë që masa mbrojtëse të përshtatshme të jenë vendosur dhe të respektohen kur ndërmerren inspektive ose masa të tjera në pajtim me mbikëqyrjen e profesionit.

3. Palët sigurojnë që shoqatat profesionale, në bazë të kufizimeve të përcaktuara me ligj dhe të nevojshme në një shoqëri demokratike për parandalimin, hetimin dhe ndjekjen penale të një krimi ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, të jenë në gjendje të mbrojnë të drejtat e përcaktuara në këtë Konventë, duke përfshirë:

a. nëpërmjet përfaqësuesve të tyre, akses efektiv tek avokatët e privuar nga liria, nëse avokatët përkatës e kërkojnë këtë;

b. informimin pa vonesë të panevojshme për rastet për të cilat autoritetet ligjzbatuese janë në dijeni, të avokatëve që sulmohen ose vriten kur ka arsye për të besuar se kjo ndodh për shkak të veprimtarive të tyre profesionale dhe këto raste nuk janë bërë ndryshe publike dhe kur avokatët nuk janë në gjendje t'i informojnë vetë;

c. mundësinë për të marrë pjesë në seanca dëgjimore në ndonjë procedim të ngritur kundër avokatëve, kur ka arsye për të besuar se kjo ka ndodhur për shkak të veprimtarive të tyre profesionale.

4. Palët:

a. do të sigurojnë që avokatët dhe shoqatat e tyre profesionale të jenë në gjendje të kryejnë veprimtaritë e tyre profesionale dhe të ushtrojnë të drejtat e tyre sipas Nenit 7 të kësaj Konvente, pa qenë objekt i:

i. ndonjë forme sulmi fizik, kërcënimi, ngacmimi ose frikësimi; ose

ii. ndonjë pengese ose ndërhyrjeje të papërshtatshme;

b. do të përmbahen nga përfshirja në sjelljen e specifikuar në nënparagrafin a të këtij paragrafi; dhe

c. do të kryejnë një hetim efektiv mbi ndodhjen e sjelljes së specifikuar në nënparagrafin a të këtij paragrafi, kur ka arsye për të besuar se kjo mund të përbëjë vepër penale.

5. Palët do të përmbahen nga miratimi i ndonjë mase ose mbështetjeje të ndonjë praktike që do të dëmtonte pavarësinë dhe natyrën vetëqeverisëse të shoqatave profesionale.

Kapitulli III – Mekanizmi monitorues

Neni 10 – Grupi i Ekspertëve për Mbrojtjen e Profesioneve të Avokatit

1. Grupi i Ekspertëve për Mbrojtjen e Profesioneve të Avokatit (në vijim i referuar si GRAVO) do të monitorojë zbatimin e kësaj Konvente nga Palët.

2. GRAVO do të përbëhet nga një numër minimal prej tetë anëtarësh dhe një numër maksimal prej 12 anëtarësh. Anëtarët e tij do të zgjidhen nga Komiteti i Palëve, i krijuar nga Neni 11 i kësaj Konvente, nga kandidatët e emëruar nga Palët për një mandat katërvjeçar, të rinovueshëm një herë, dhe të zgjedhur nga shtetasit e Palëve.

3. Zgjedhja fillestare e tetë anëtarëve do të mbahet brenda një periudhe prej një viti pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente. Zgjedhja e katër anëtarëve shtesë do të mbahet pas ratifikimit ose aderimit të 25-të.

4. Zgjedhja e anëtarëve të GRAVO-s do të bazohet në parimet e mëposhtme:

a. anëtarët do të zgjidhen sipas një procedure transparente nga radhët e personave me karakter të lartë moral, të cilët kanë treguar përvojë profesionale në fushat e mbuluara nga kjo Konventë;

b. dy anëtarë të GRAVO-s nuk mund të jenë shtetas të të njëjtit Shtet;

c. anëtarët duhet të përfaqësojnë sisteme të ndryshme ligjore;

d. përbërja e GRAVO-s do të sigurojë një balancë gjinore dhe gjeografike;

e. anëtarët do të marrin pjesë në cilësinë e tyre individuale dhe do të jenë të pavarur dhe të paanshëm në ushtrimin e funksioneve të tyre dhe do të jenë të disponueshëm për të kryer detyrat e tyre në mënyrë efektive.

5. Procedura e zgjedhjes së anëtarëve të GRAVO-s do të përcaktohet nga Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës, pas konsultimit dhe marrjes së pëlqimit unanim të Palëve, brenda një periudhe prej gjashtë muajsh pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente.

6. GRAVO do të miratojë rregullat e veta të procedurës.

7. Anëtarët e GRAVO-s dhe anëtarët e tjerë të delegacioneve që vizitojnë vende, siç përcaktohet në Nenin 12 të kësaj Konvente, gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e përcaktuara në shtojcën e kësaj Konvente.

Neni 11 – Komiteti i Palëve

1. Komiteti i Palëve do të përbëhet nga përfaqësuesit e Palëve të kësaj Konvente dhe Palët do të përpiqen të arrijnë balancën gjinore në përbërjen e tij.

2. Komiteti i Palëve do të thirret nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës. Mbledhja e tij e parë do të mbahet brenda një periudhe prej një viti pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente. Më pas do të mbledhet sa herë që një e treta e Palëve, Presidenti i Komitetit të Palëve ose Sekretari i Përgjithshëm e kërkojnë këtë.

3. Komiteti i Palëve do të miratojë rregullat e veta të procedurës.

Neni 12 – Procedura

1. Procedurat e vlerësimit do të ndahen në raunde. GRAVO do të përcaktojë fushëveprimin dhe mjetet e përshtatshme për të kryer këtë procedurë, të tilla si pyetësorët që mund të shërbejnë si bazë për procedurën e vlerësimit të zbatimit nga Palët.

2. GRAVO do të marrë informacion mbi zbatimin e Konventës nga Pala e interesuar. Përveç kësaj, mund të marrë informacion mbi zbatimin e Konventës nga organizatat joqeveritare dhe shoqëria civile, shoqatat profesionale, si dhe nga institucionet kombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. GRAVO gjithashtu do të marrë në konsideratë informacionin e disponueshëm nga instrumentet dhe organet e tjera të Këshillit të Evropës, si dhe nga organizata të tjera rajonale dhe ndërkombëtare, në fushat që hyjnë brenda fushëveprimit të kësaj Konvente.

3. GRAVO mund të organizojë vizita në vende të ndryshme, në bashkëpunim me autoritetet kombëtare dhe, kur është e nevojshme, me ndihmën e ekspertëve të pavarur kombëtarë, nëse

informacioni i përftuar është i pamjaftueshëm dhe nuk ka mënyra të tjera të mundshme për të përftuar informacionin në mënyrë të besueshme ose në rastet e parashikuara në Nenin 13, paragrafi 2 të kësaj Konvente. Vizitat do të jenë dytësore dhe të kufizuara në zonat ku GRAVO vendos që informacioni është i pamjaftueshëm dhe në rastet e parashikuara në Nenin 13, paragrafi 2 të kësaj Konvente.

4. Vizitat do të kryhen nga një delegacion i GRAVO-s. Gjatë vizitave, delegacioni mund të ndihmohet nga specialistë në fusha specifike. Gjatë vizitave, delegacioni duhet:

- i. të gëzojë lirinë e lëvizjes në juridiksionin përkatës;
- ii. të jetë në gjendje të ketë kontakt me autoritetet shtetërore;
- iii. të mos pengohet të takojë personat që dëshiron të intervistojë privatisht;
- iv. të ketë akses në materialin përkatës për vizitën në atë vend.

5. GRAVO do të përgatisë një draft raport që përmban analizën e tij në lidhje me zbatimin e dispozitave mbi të cilat bazohet vlerësimi, si dhe sugjerimet dhe propozimet e tij mbi mënyrën sesi Pala e interesuar mund të trajtojë problemet e identifikuara. Draft raporti do t'i transmetohet për komente Palës që i nënshtrohet vlerësimit. Komentet e saj do të merren parasysh nga GRAVO gjatë miratimit të raportit të tij.

6. Në bazë të të gjitha informacioneve të marra dhe komenteve nga Pala e interesuar, GRAVO do të miratojë raportin dhe përfundimet e tij në lidhje me masat e marra nga Pala për të zbatuar dispozitat e kësaj Konvente. Ky raport dhe përfundimet i do t'i dërgohen Palës së interesuar dhe Komitetit të Palëve. Raporti dhe përfundimet e GRAVO-s do të bëhen publike që nga miratimi i tyre, së bashku me çdo koment nga Pala e interesuar.

7. Pa cenuar procedurën e paragrafëve 1 deri 6 të këtij neni, Komiteti i Palëve mund të miratojë, në bazë të raportit dhe përfundimeve të GRAVO-s, rekomandime drejtuar Palës së interesuar:

- a. në lidhje me masat që duhen marrë për të zbatuar përfundimet e GRAVO-s, duke caktuar nëse është e nevojshme, një datë për dorëzimin e informacionit mbi zbatimin e tyre; dhe
- b. duke synuar nxitjen e bashkëpunimit me këtë Palë për zbatimin e duhur të kësaj Konvente.

Neni 13 – Procedura urgjente

1. Nëse GRAVO merr informacion të besueshëm që tregon një situatë ku problemet kërkojnë vëmendje të menjëhershme për të parandaluar ose kufizuar shkallën ose numrin e shkeljeve të

rënda të Konventës, ajo mund të kërkojë nga Pala e interesuar dorëzimin urgjent të një raporti të posaçëm në lidhje me masat e marra për të parandaluar shkelje të tilla.

2. Duke marrë parasysh informacionin e paraqitur nga Pala e interesuar, si dhe çdo informacion tjetër të besueshëm në dispozicion të saj, GRAVO mund të caktojë një ose më shumë anëtarë të saj për të kryer një hetim dhe për të raportuar urgjentisht tek GRAVO. Kur është e justifikuar dhe me pëlqimin e Palës së interesuar, hetimi mund të përfshijë një vizitë në territorin e saj.

3. Pas shqyrtimit të gjetjeve të hetimit të përmendur në paragrafin 2 të këtij neni, GRAVO do t'ia transmetojë këto gjetje Palës së interesuar dhe, kur është e nevojshme, Komitetit të Palëve, Komitetit të Ministrave dhe Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, së bashku me komente dhe rekomandime. Raporti dhe përfundimet e GRAVO-s bëhen publike që nga miratimi i tyre, së bashku me komentet nga Pala e interesuar.

Neni 14 – Opinionet

GRAVO mund të miratojë, kur është e nevojshme, opinione mbi zbatimin e kësaj Konvente.

Neni 15 – Marrëdhënia me organet e tjera

Komiteti i Ministrave dhe Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës informohen periodikisht për zbatimin e kësaj Konvente.

Kapitulli IV – Marrëdhënia me instrumentet e tjera ndërkombëtare

Neni 16 – Marrëdhënia me instrumentet e tjera ndërkombëtare

1. Kjo Konventë nuk do të ndikojë në të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga instrumente të tjera ndërkombëtare në të cilat Palët e kësaj Konvente janë Palë ose do të bëhen Palë dhe të cilat përmbajnë dispozita mbi çështjet e rregulluara nga kjo Konventë dhe që sigurojnë mbrojtje më të zgjeruar për të drejtën e avokatëve për të ushtruar lirisht profesionin e tyre.

2. Palët e kësaj Konvente mund të lidhin marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe me njëra-tjetrën mbi çështjet e trajtuara në këtë Konventë, me qëllim plotësimin ose forcimin e dispozitave të saj ose lehtësimin e zbatimit të parimeve të përcaktuara në të.

Kapitulli V – Klauzolat përfundimtare

Neni 17 – Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim nga Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, Shtetet jo-anëtare që kanë marrë pjesë në hartimin e saj dhe Bashkimi Evropian.

2. Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.
3. Kjo Konventë hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas përfundimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës në të cilën tetë nënshkrues, përfshirë të paktën gjashtë shtete anëtare të Këshillit të Evropës, kanë shprehur pëlqimin e tyre për t'u lidhur ligjërisht nga Konventa në përputhje me dispozitat e paragrafit të mëparshëm.
4. Për çdo nënshkrues që shpreh më pas pëlqimin për t'u lidhur ligjërisht prej saj, kjo Konventë hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas përfundimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

Neni 18 – Aderimi në Konventë

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës, pas konsultimit me Palët e kësaj Konvente dhe marrjes së pëlqimit të tyre unanimit, mund të ftojë çdo Shtet jo-anëtar të Këshillit të Evropës, i cili nuk ka marrë pjesë në hartimin e Konventës, të aderojë në këtë Konventë me anë të një vendimi të marrë nga shumica e parashikuar në Nenin 20.d të Statutit të Këshillit të Evropës dhe me votë unanime të përfaqësuesve të Shteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të marrin pjesë në Komitetin e Ministrave.
2. Për çdo shtet aderues, Konventa hyn në fuqi ditën e parë të muajit që pason përfundimin e një periudhe prej tre muajsh pas datës së depozitimit të instrumentit të aderimit tek Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës.
3. Çdo Palë që nuk është anëtare e Këshillit të Evropës, do të kontribuojë në financimin e veprimtarive të GRAVO-s dhe Komitetit të Palëve, sipas kushteve të përcaktuara nga Komiteti i Ministrave.

Neni 19 – Zbatimi territorial

1. Çdo shtet ose Bashkimi Evropian, në kohën e nënshkrimit ose kur depoziton instrumentin e tij të ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit, mund të përcaktojë territorin ose territoret në të cilat do të zbatohet kjo Konventë
2. Çdo Palë, në çdo datë të mëvonshme, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, mund të shtrijë zbatimin e kësaj Konvente në çdo territor tjetër të specifikuar në deklaratë dhe për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit është përgjegjës ose në emër të të cilit është e autorizuar që të ndërmarrë angazhime. Në lidhje me një territor të tillë, Konventa hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas përfundimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së një deklarate të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm.
3. Çdo deklaratë e bërë sipas dy paragrafëve të mësipërm mund të tërhiqet, në lidhje me çdo territor të specifikuar në këtë deklaratë, me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës. Kjo tërheqje hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas përfundimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së një njoftimi të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 20 – Deklaratat

1. Çdo Palë Kontraktuese e kësaj Konvente, në kohën e nënshkrimit ose kur depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, do të tregojë titujt profesionalë që hyjnë në fushëveprimin e kësaj Konvente për qëllimet e Nenit 3, nënparagrafi a. Kjo deklaratë mund të ndryshohet në çdo datë të mëvonshme dhe në të njëjtën mënyrë. Kjo deklaratë dhe çdo ndryshim i saj nuk do të dëmtojë qëllimin e kësaj Konvente dhe mbrojtjen e ofruar prej saj.
2. Çdo Palë Kontraktuese e kësaj Konvente, në kohën e nënshkrimit ose kur depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, mund të deklarojë se përkufizimi i “autoriteteve publike” përfshin një ose më shumë nga organet e mëposhtme:
 - i. organet legjislative në lidhje me veprimtaritë e tyre të tjera;
 - ii. autoritetet gjyqësore në lidhje me veprimtaritë e tyre të tjera;
 - iii. personat fizikë ose juridikë në masën që kryejnë funksione publike ose veprojnë me fonde publike, sipas ligjit vendas.

Kjo deklaratë mund të ndryshohet në çdo datë të mëvonshme dhe në të njëjtën mënyrë.

Neni 21 – Rezervat

1 Çdo Shtet ose Bashkimi Evropian, në kohën e nënshkrimit ose kur depoziton instrumentin e tij të ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit, me anë të një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, mund të deklarojë se rezervon të drejtën për të mos zbatuar ose për të zbatuar vetëm në raste ose kushte specifike, dispozitat e përcaktuara në Nenin 6 në lidhje me Nenin 2, paragrafi 3, nënparagrafi b të kësaj Konvente. Asnjë rezervë tjetër nuk mund të bëhet në lidhje me dispozitat e kësaj Konvente.

2. Çdo Palë mund të tërheqë tërësisht ose pjesërisht një rezervë me anë të një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës. Kjo deklaratë hyn në fuqi që nga data e marrjes së saj nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 22 – Ndryshimet e Konventës

1. Çdo propozim për ndryshim në këtë Konventë, i paraqitur nga një Palë, i komunikohet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës dhe i përcillet prej tij ose saj Shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, Shteteve jo-anëtare që kanë marrë pjesë në hartimin e tij, çdo Shteti nënshkrues, çdo Shteti Palë, Bashkimit Evropian dhe çdo Shteti të ftuar për të aderuar në këtë Konventë në përputhje me dispozitat e Nenit 18, paragrafi 1.

2. Çdo ndryshim i propozuar nga një Palë, i komunikohet Komitetit të Palëve, i cili i paraqet Komitetit të Ministrave mendimin e tij mbi ndryshimin e propozuar.

3. Komiteti i Ministrave do të shqyrtojë ndryshimin e propozuar dhe mendimin e paraqitur nga Komiteti i Palëve dhe pas konsultimit me Shtetet Palë jo-anëtare të kësaj Konvente, mund ta miratojë këtë ndryshim.

4. Teksti i çdo ndryshimi të miratuar nga Komiteti i Ministrave në përputhje me paragrafin 3 të këtij Neni, u përcillet Palëve për pranim.

5. Çdo ndryshim i miratuar në përputhje me paragrafin 3 të këtij Neni, hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas përfundimit të një periudhe prej një muaji pas datës në të cilën të gjitha Palët kanë informuar Sekretarin e Përgjithshëm se e kanë pranuar atë.

Neni 23 – Denoncimi

1. Çdo Palë mund ta denoncojë këtë Konventë në çdo kohë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

2. Një denoncim i tillë do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas përfundimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 24 – Njoftimet

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do të njoftojë Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, Shtetet jo-anëtare që kanë marrë pjesë në hartimin e saj, çdo Shtet nënshkrues, çdo Shtet Palë, Bashkimin Evropian dhe çdo Shtet të ftuar për të aderuar në këtë Konventë në përputhje me dispozitat e Nenit 18 për:

- a. çdo nënshkrim;
- b. depozitim të çdo instrumenti ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi;
- c. çdo datë hyrjeje në fuqi të kësaj Konvente në përputhje me Nenin 17 dhe 18;
- d. çdo ndryshim të miratuar në përputhje me Nenin 22 dhe datën në të cilën një ndryshim i tillë hyn në fuqi;
- e. çdo deklaratë të bërë në përputhje me Nenin 20;
- f. çdo rezervë dhe tërheqje të rezervës së bërë në përputhje me Nenin 21;
- g. çdo denoncim të bërë në përputhje me Nenin 23;
- h. çdo akt, njoftim ose komunikim tjetër që lidhet me këtë Konventë.

NË DËSHMI TË KËSAJ, të poshtëshënuarit, të autorizuar rregullisht, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Luksemburg, më 13 maj 2025, në anglisht dhe frëngjisht, ku të dy tekstet janë njëloj autentikë, në një kopje të vetme e cila do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Evropës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do t'u transmetojë kopje të vërtetuara çdo Shteti anëtar të Këshillit të Evropës, shteteve jo-anëtare që kanë marrë pjesë në hartimin e kësaj Konvente, çdo Shtet nënshkrues, Bashkimit Evropian dhe çdo Shtet të ftuar për të aderuar në këtë Konventë.

Shtojca – Privilegjet dhe imunitetet (Neni 10)

1. Kjo shtojcë do të zbatohet për anëtarët e GRAVO-s të përmendur në Nenin 10 të kësaj Konvente, si dhe për anëtarët e tjerë të delegacioneve që vizitojnë vende. Për qëllimet e kësaj shtojce, shprehja “anëtarë të tjerë të delegacioneve që vizitojnë vende” do të përfshijë ekspertët e pavarur kombëtarë dhe specialistët e përmendur në Nenin 12, paragrafët 3 dhe 4 të kësaj Konvente, anëtarët e stafit të Këshillit të Evropës dhe përkthyesit e punësuar nga Këshilli i Evropës që shoqërojnë GRAVO-n gjatë vizitave të tij në vende.

2. Anëtarët e GRAVO-s dhe anëtarët e tjerë të delegacioneve që vizitojnë vende, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre në lidhje me përgatitjen dhe kryerjen e vizitave në vende, si dhe ndjekjen e tyre dhe udhëtimin në lidhje me këto funksione, gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e mëposhtme:

a. imunitet nga arrestimi ose ndalimi personal dhe nga sekuestrimi i bagazhit të tyre personal, si dhe imunitet nga çdo lloj procesi ligjor në lidhje me fjalët e thëna ose të shkruara dhe të gjitha veprimet e kryera prej tyre në cilësinë e tyre zyrtare;

b. përjashtim nga çdo kufizim në lirinë e tyre të lëvizjes gjatë daljes dhe kthimit për në vendin e tyre të banimit, dhe hyrjes dhe daljes nga vendi në të cilin ushtrojnë funksionet e tyre, dhe nga regjistrimi i të huajve në vendin që ata vizitojnë ose nëpër të cilin kalojnë gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.

3. Gjatë udhëtimeve të ndërmarra në ushtrimin e funksioneve të tyre, anëtarët e GRAVO-s dhe anëtarët e tjerë të delegacioneve që vizitojnë vende, në çështjet e doganave dhe kontrollit të këmbimit, do t’u jepen të njëjtat lehtësira si ato që u jepen përfaqësuesve të qeverive të huaja në detyrë zyrtare të përkohshme.

4. Dokumentet që lidhen me vlerësimin e zbatimit të kësaj Konvente, të mbajtura nga anëtarët e GRAVO-s dhe anëtarë të tjerë të delegacioneve që vizitojnë vende, janë të paprekshme. Asnjë ndalim ose censurë nuk do të zbatohet ndaj korrespondencës zyrtare të GRAVO-s ose komunikimeve zyrtare të anëtarëve të GRAVO-s dhe anëtarëve të tjerë të delegacioneve që vizitojnë vende.

5. Me qëllim që anëtarëve të GRAVO-s dhe anëtarëve të tjerë të delegacioneve që vizitojnë vende, t’u sigurohet liria e plotë e shprehjes dhe pavarësia e plotë në kryerjen e detyrave të tyre, imuniteti nga procesi ligjor në lidhje me fjalët e thëna ose të shkruara dhe të gjitha veprimet e kryera prej tyre në kryerjen e detyrave të tyre, do të vazhdojë të jepet, pavarësisht se personat përkatës nuk janë më të angazhuar në kryerjen e detyrave të tilla.

6. Privilegjet dhe imunitetet u jepen personave të përmendur në paragrafin 1 të kësaj shtojce, me qëllim që të mbrohet ushtrimi i pavarur i funksioneve të tyre në interes të GRAVO-s dhe jo për përfitimin e tyre personal. Heqja e imuniteteve të personave të përmendur në paragrafin 1 të kësaj shtojce, do të bëhet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës në çdo rast kur, sipas mendimit të tij ose të saj, imuniteti do të pengonte zhvillimin e drejtësisë dhe kur ai mund të hiqet pa cenuar interesat e GRAVO-s.